



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë / /2024
Nr. Dok. 202301105/6

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për krijimin dhe ngritjen e strukturave për trajtimin e problematikës së qenve endacakë në Bashkinë Dropull.*

BASHKISË

DROPULL

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË VETERINARISË DHE MBROJTJES
SË BIMËVE**

Rruga "Jordan Misja", pallati 141/1, shkalla 1, kati 2

TIRANË

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E SIGURISË
USHQIMORE, VETERINARISË, MBROJTJES SË BIMËVE DHE PESHKIMIT
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

TIRANË

Të nderuar,

Në ankesën drejtuar Avokatit të Popullit, shtetasi S.P ka shprehur shqetësimin në lidhje me disiplinimin e qenve të rrugës, endacakë, pasi është sulmuar nga një grup qenësh që e kanë kafshuar duke i sjellë probleme shëndetësore.

Sikundër ai shkruan, z. S.P është banor i fshatit Vrisera në Njësinë Administrative Dropull i Sipërm, në bashkinë Dropull. Në momentin e ngjarjes ankuesi është drejtuar në Qendrën Shëndetësore Vrisera ku mori ndihmën e shpejtë dhe injeksionin tetanoz që aplikohet në rast kafshimi nga qentë endacakë, si masë parandaluese ndaj sëmundjeve të rrezikshme për jetën e njeriut që përcillet nga kafsha. Ankuesi kërkon që në njësinë ku banon të ketë sigurinë për të ecur i qetë pa pësuar sulme fizike, ndërsa respektohet edhe jeta e kafshëve.

Në këto rrethana, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për sqarimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje. Me qëllim hetimin administrativ të çështjes dhe vlerësimin e pretendimeve të ankuesit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e njërive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar” (VKM nr. 475/2021), kemi kërkuar, me shkresën nr. K3/S33 – 2 prot., datë 27.05.2024, “Kërkesë për informacion dhe shpjegime” Njësisë Administrative Dropull i Sipërm dhe Bashkisë Dropull, informacion se cilat ka qenë masat dhe veprimet e ndërmarra për zgjidhjen e këtij shqetësimi, por edhe arsytet në rast mosveprimi.

Në përgjigjen e dhënë me shkresën nr. 744/1 prot., datë 05.06.2024, nga Bashkia Dropull informohemi se: “... Kjo problematikë është trajtuar nga Bashkia Dropull dhe brenda kompetencave ligjore janë marrë masa siç tregon praktika si vijon. Bashkia Dropull ka marrë masat për administrimin e plehrave në territorin e saj pasi janë burim për qentë e rrugës. Bashkia Dropull për mungesë fondesh nuk ka strehëz për qentë endacakë”.

Në dokumentacionin shkresor të vënë në dispozicion nga Bashkia Dropull, rezulton se kjo problematikë është ngritur edhe nga ana e Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Gjirokastër. Më konkretisht, rezulton se, me shkresën nr. 538 prot., datë 07.07.2023 Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Ministria e Brendshme, i është drejtuar Bashkisë Dropull duke shprehur shumë qartë problematikën dhe kërkesën për rastin në fjalë si vijon: “Nëpërmjet kësaj shkrese ju kërkojmë që në zbatim të “Ligjit për shërbimin dhe inspektoratin veterinar nr1046, datë 29.09.2011, për organizimin dhe kontrollin shëndetësor, zbatimin e masave profilaktike dhe higjeno-sanitare”, Urdhrit të Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 227, datë 24.02.2020 “Për miratimin e procedurave standarde të punës për përzgjedhjen, profilaksinë, nxjerrjen jashtë të përdorimit të qenve të policisë, si dhe bashkëpunimi midis shkollave homologe”, “Procedurat standarde të punës për trajnimin dhe certifikimin e qenve të policisë dhe trajtimit në strukturat vendore”, Planit të masave nr.356, datë 31.03.2023 e grafikut të testimit të IPQ Policisë, trajtimit, strehimit, trajtimit të qenve të policisë”, të merren masa nga organet e pushtetit vendor për largimin e qenve të rrugës që jetojnë në territorin e SPK, pasi përbëjnë rrezik potencial për transmetimin e sëmundjeve infektive dhe parazitare si dhe në cilësinë e kryerjes së shërbimit të skuadrave të qenëve policor.”

Me shkresën nr. 1039/1 prot., datë 27.07.2023, Bashkia Dropull ka mbajtur qëndrimin si vijon: “Në përgjigje të shkresës tuaj...administruar pranë Bashkisë Dropull...ku kërkohet marrja e masave për largimin e qenve endacakë nga territori i SPK Kakavijë, ju informojmë se Bashkia Dropull ka marrë masat për administrimin e plehrave në SPK Kakavijë njësoj si në të gjithë

territorin që kjo Bashki mbulon, duke evituar kabanët e hapur apo përgjethjet e plehrave si dhe heqjen e mbetjeve nga koshat në mënyrë periodike, pasi këto shpesh tërheqin qentë e rrugës, por edhe kafshë të tjera. Bashkia për mungesë fondesh nuk ka akoma një strehëz për qentë endacak. Bashkia me specialistët veteriner ofron bashkëpunim për çdo rast kur ju do na informoni se qentë e policisë por edhe qytetarët ndihen të kërcënuar nga qentë endacakë.”

Sa më sipër, nga përgjigja konstatohet se nuk është kushtuar vëmendja e duhur ndaj kësaj problematike dhe se nuk tregohet një bashkëpunim proaktiv për zgjidhjen e saj.

Një ndër funksionet e veta të Bashkisë Dropull, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në përputhje me përcaktimin e dhënë në nenin 23, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar (ligji nr. 139/2015) është: “...bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: ... 9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. 10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake...”

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështesin veprimtarinë e tyre të përditshme pikërisht në konceptin e autonomisë vendore, të kuptuar si, “... e drejta dhe aftësia e njësive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”, siç parashikohet në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.139/2015 dhe ligjit nr. 10 465, datë 29.11.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, (ligji nr. 10465/2011).

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 dhe përmbushjes së misionit për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave, por edhe përgjegjësi që ka njësia e vetëqeverisjes vendore konkretisht, Bashkia Dropull, ka miratuar Rregulloren e Brendshme të veprimtarisë së saj

Në Vendimet e publikuara të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Dropull (VKB), “Për miratimin e Rregullosës së Brendshme “Për Organizimin, Funkcionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Dropull”, në ndryshimet e bëra ndër vite, evidentohen konkretisht parashikimet ligjore të mëposhtme:

- Në VKB-në nr. 34, datë 19.09.2016¹, në nenin 77 parashikohet “Agjensia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore”, e cila ka si përgjegjësi ofrimin e të gjitha shërbimeve në lidhje me bujqësinë, ujëtimin, kullimin, veterinarinë dhe profilaksinë e kafshëve, pyjet dhe kullotat. Ndërsa pika 4 e nenit 79, të kësaj VKB-je parashikon detyrën e veterinerit për të mbajtur nën kontroll dhe zbatuar legjislacionin në fuqi për eliminimin e qenve dhe maceve të rrugës.
- Në VKB-në nr. 14, datë 20.03.2019², në nenin 75, parashikohet “Drejtoria e Administrimit të Ujërave, të Pyjeve, të Livadheve dhe Kullotave”, e cila është

¹ <https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-dropull-nr-34-data-19-09-2016/>

² <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2019/04/Vendim-Nr.-14-date-20.03.20193.pdf>

përgjegjëse për ofrimin e të gjitha shërbimeve në lidhje me bujqësinë, ujitjen, kullimin, veterinarinë dhe, pyjet, kullotat, livadhet. Drejtoria ka për detyrë të kryejë funksione këshillimi dhe mbështetje për komunitetin duke ofruar vetëm ato shërbime që duhet të ofrohen në terren. Kjo Drejtori në strukturën e saj përllogarit 15 punonjës, ndër të cilët specialistin për Këshillime Veterinere. Në nenin 77 të kësaj VKB-je parashikohen detyrat e “Specialistit për Këshillime Veterinere”, ndër të cilat, ndjekja e punës që bëhet në zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes së mjedisit nga institucionet shtetërore a private që veprojnë në territorin e bashkisë (pika 2 e VKB-së); mbajtja nën kontroll dhe zbatimi i legjislacionit në fuqi për eliminimin e qenve dhe maceve të rrugës (pika 7 e VKB-së); zbatimi i funksioneve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në territorin e njësisë administrative (pika 8 e VKB-së).

- Në VKB-në nr. 14, datë 31.03.2021³, në nenin 72 parashikohet “Drejtoria e Administrimit të Ujërave, të Pyjeve, të Livadheve dhe Kullotave”, e cila është përgjegjëse për ofrimin e të gjitha shërbimeve në lidhje me bujqësinë, ujitjen, kullimin, veterinarinë dhe, pyjet, kullotat, livadhet. Drejtoria ka për detyrë të kryejë funksione këshillimi dhe mbështetje për komunitetin duke ofruar vetëm ato shërbime që duhet të ofrohen në terren. Po ashtu, (citojmë) në këtë dispozitë parashikohet: *Për rrjedhojë, nga fusha e kompetencave të saj (referuar këtu Drejtorisë së Administrimit të Ujërave, të Pyjeve, të Livadheve dhe Kullotave) përjashtohet planifikimi, politikbërja apo monitorimi i cilësisë dhe mënyrës së dhënies së këtyre shërbimeve.*

Nga një lexim i dispozitave të kësaj VKB-je konstatohet gjithashtu që kjo Drejtori në strukturën e saj përfshin edhe specialist për këshillime veterinerë, por që nuk ka një dispozitë ku përcaktohen detyrat e këtij specialisti.

- Në VKB-në nr. 13, datë 29.03.2024⁴, referuar përmbajtjes së Relacionit “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Dropull, për vitin 2024”, referohen ndryshimet e bëra në këtë VKB, që konsistojnë në: Krijimin e Drejtorisë së re me emërtesën Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe e Strehimit; janë shtuar detyrat e Specialistit të Menaxhimit të Pyjeve, në Drejtorinë e Administrimit të Ujërave, Pyjeve dhe Livadheve; janë shtuar detyrat e Specialistit të Inxhinier Ndërtimit, në Drejtorinë e Shërbimit Urban; janë shtuar detyrat e shoqërues guidë, në Sektorin e Kulturës, Arsimit dhe Sportit; janë shtuar detyrat e punonjësit në studion e polifonisë, në Sektorin e Kulturës, Arsimit dhe Sportit; janë shtuar detyrat e punonjësit të Bibliotekës, në Sektorin e Kulturës, Arsimit dhe Sportit.

³ <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim-nr.-14-date-31.03.2021.pdf>

⁴ <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2024/06/Vendim-nr-13-date-29.03.2024.pdf>

Përmbajtja e kësaj VKB-je nuk pasqyrohet në faqen zyrtare të Bashkisë Dropull, vetëm relacioni shoqërues i saj.

Për sa pasqyruar më sipër, lidhur me problematikën e marrë në shqyrtim, për mënyrën e trajtimit të kafshëve endacakë në hapësirat territoriale të Bashkisë Dropull dhe aksidenteve që kanë ardhur, evidentohet fakti se dispozitat në vendimet e Këshillit Bashkiak Dropull janë përkeqësuar, duke mosparashikuar fare shërbimin për “Veterinarinë”, në zbatim të ligjit nr. 10465/2011 dhe VKM-së nr. 475/2021.

Ligji 10465/2011, në gjurmën c), neni 54, parashikon se: *“Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të mbajnë nën kontroll dhe të zbatojnë kërkesat e këtij ligji për kontrollin e qenve e të maceve të rrugës, duke bashkëpunuar me shërbimin veterinar shtetëror”*.

Në këtë kuptim të ligjit, Bashkisë Dropull i lind detyrimi të hartojë dhe zbatojë një strategji në përputhje me Legjislacionin Veterinar Shqiptar dhe në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian për të drejtat e kafshëve për zbutjen dhe eliminimin e kësaj shtate, duke mbrojtur shëndetin e qytetarëve, shëndetin e qenve dhe maceve endacak në territorin e saj.

Gjithashtu, pika 2, neni 54, e ligjit nr. 10465/2011 parashikon se: *“Mënyrat e bashkëpunimit, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”*. Në funksion të parashikimit të kësaj dispozite ligjore, neni 54, pika 2, të ligjit nr. 10465/2011, është mundësuar nxjerrja e VKM-së nr. 230, datë 20.03.2013 *“Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”*, shfuqizuar me VKM-në nr. 475, datë 30.07.2021, *“Për bashkëpunimin e njërive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”*. Në Kreun III, *“Mbikqyrja dhe mbajtja në kontroll e qenve dhe maceve endacake pa pronarë”*, të VKM-së nr. 475/2021, përcaktohet, se:

“ 1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbajnë nën kontroll lëvizjen e qenve dhe maceve të rrugës. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në lidhje me situatën epizotike të qenve dhe maceve të rrugës, në rast dyshimi, njoftojnë menjëherë drejtoritë rajonale të AKVMB-së. AKVMB-ja siguron zbatimin e programeve të profilaksisë veterinare në lidhje me kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve epizootike.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore identifikojnë të gjithë qentë dhe macet e rrugës në territorin që ata administrojnë, në një regjistër sipas modelit të hartuar nga SPV-ja (struktura përgjegjëse për veterinarinë). Njësitë e vetëqeverisjes vendore vënë në dispozicion të AKVMB-së të dhënat e regjistrit, sa herë që i kërkohet.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë hospitalizimin e qenve dhe të maceve të rrugës nëpërmjet organizimit, grumbullimit të tyre në vende të posaçme të miratuara nga autoritetet e vetëqeverisjes vendore. Shërbimi veterinar në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë sterilizimin e tyre, me qëllim ndërprerjen e aktivitetit prodhues. Mbetjet e gjeneruara nga kryerja e sterilizimit të qenve dhe maceve të rrugës duhet të klasifikohen, etiketohen, grumbullohen, transportohen, trajtohen dhe të asgjësohen në përputhje me detyrimet e kërkesave të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, si dhe me aktet e tjera ligjore në fuqi, në fushën e mjedisit.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në çdo rast organizojnë dhe vënë në dispozicion mjetet për transportin e qenve dhe maceve në qendrat e grumbullimit. Shërbimi veterinar i AKVMB-së siguron që mjetet e vëna në dispozicion të plotësojnë standardet e mirëqenies së kafshëve. Në

çdo rast këto mjete duhet të dezinfektohen me dezinfektantë të miratuar sipas legjislacionit në fuqi.

5. Në mjediset e qendrave të hospitalizimit ose të qendrave të grumbullimit të kafshëve të miratuara nga autoritetet e vetëqeverisjes vendore kryhet eliminimi i kafshëve me metodën e eutanazisë nga shërbimi veterinar, duke përdorur një nga produktet mjekësore veterinare të miratuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Në të gjitha rastet kur ka braktisje të qenve dhe maceve nga pronarët përkatës, njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa për strehimin e tyre në ambiente të përshtatshme dhe zbatimin e të gjitha masave të nevojshme për shëndetin dhe kushtet e mirëqenies së tyre. Njësitë e vetëqeverisjes vendore informojnë brenda 10 (dhjetë) ditësh shërbimin veterinar të AKVMB-së lidhur me masat e marra.

7. ... ”.

Funksioni i Agjencisë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB-së)⁵ përcaktohet me VKM-në nr. 683, datë 02.09.2020 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”. AKVMB-ja ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit dhe ka fushë përgjegjësie shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve, pra të garantojë mbrojtjen e shëndetit të mirëqenies së kafshëve, që automatikisht çon në mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët.

Sipas ligjit nr. 10465/2011, neni 4, përkufizohet se shërbimi veterinar është i organizuar në sistem të centralizuar shtetëror me qendër në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) dhe ka në strukturën e saj Drejtorinë e Politikave Veterinare, pjesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit. Ndërkohë, AKVMB-ja ushtron kompetencat, në linjë me politikat e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, dhe shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë që organizohet në nivel qendror⁶ dhe në nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve, Tiranë, Elbasan, Vlorë, Shkodër dhe nëpërmjet njërive direkte të ofrimit të shërbimit veterinar.

Thënë kjo, shërbimi Veterinar i Bashkisë Dropull është pjesë e strukturës shtetërore nga e cila ka varësi teknike, lidhur me këtë shërbim, që mbulohet nga Drejtoria Rajonale Vlorë e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të AKVMB-së. Në këtë kontekst mbajmë qëndrimin

⁵ AKVMB është krijuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të nenit 128, të ligjit nr.10465 datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Këshillit të Ministrave.

⁶ Shih pikën 5 dhe 5/1 të nenit 4 “Përkufizimet” të ligjit nr. 10465/2011 ku parashikohet se: ...5. *Struktura përgjegjëse për inspektimin, kontrollin zyrtar dhe aktivitetet e tjera veterinare në varësi të ministrit për bujqësinë është struktura e shërbimit veterinar shtetëror, përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së shërbimit veterinar në kryerjen e kontrollit zyrtar dhe aktivitetëve të tjera veterinare në varësi të ministrit. 5/1. Autoriteti kompetent qendror është drejtoria përgjegjëse për veterinarinë në ministri.*”

se për shërbimin e Veterinarisë kjo Bashki rezulton të mos ushtrojë kontrollin mbi lëvizjet e qenve të rrugës (endacakë), të cilët, paraqesin rrezikshmëri për cenimin e shëndetit dhe jetës së njerëzve.

Jeta e personit sipas sanksionimit në nenin 21 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbrohet me ligj. Në funksion të parandalimit të dëmtimit dhe mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së personit, VKB-të e Bashkisë Dropull nuk përcaktojnë se kush është organi përgjegjës për ushtrimin e kompetencave në kontrollin për fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike. Po kështu, theksojmë se njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin e kontrollit të lëvizjes së qenve të rrugës (endacakë) si dhe trajtimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështeten në veprimtarinë e tyre të përditshme pikërisht në konceptin e autonomisë vendore, të kuptuar si, “... e drejta dhe aftësia e njërive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”, siç parashikohet në pikën 2, neni 2, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit, vlerëson se Bashkia Dropull përveçse duhet të jetë autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe zbatimin e normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, duhet veçanërisht që kjo njësi e vetëqeverisjes vendore të vendosë në zbatim edhe kontrollin e lëvizjes së qenve dhe maceve të rrugës.

Avokati i Popullit thekson faktin se strukturat e Bashkisë Dropull, në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor për mbrojtjen dhe garantimin e një mjedisi sa më të shëndetshëm, nuk duhet të neglizhojnë detyrat dhe përgjegjësitë funksionale, në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, duke vënë në dispozicion të tyre të gjithë mjetet dhe kapacitetet njerëzore dhe financiare që disponojnë me qëllim përmirësimin e standardit të jetesës.

Institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar ndër vite një vëmendje të veçantë trajtimit të ankesave dhe problematikave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e qytetarit dhe garantimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit të tyre, duke sensibilizuar dhe ndërgjegjësuar ndër të tjera edhe organet e administratës publike për ushtrimin rigoroz të funksioneve dhe përgjegjësi të ligjore

Nga hetimi administrativ i kryer nga ana jonë rezulton se Bashkia Dropull nuk respekton detyrat e parashikuara në Kreun III të VKM nr. 475/2021.

Për sa parashtruar si dhe referuar përgjigjes nga ana juaj se: “... Kjo problematikë është trajtuar nga Bashkia Dropull dhe brenda kompetencave ligjore janë marrë masa siç tregon praktika si vijon. Bashkia Dropull ka marrë masat për administrimin e plehrave në territorin e saj pasi janë burim për qentë e rrugës”, nuk mund të konsiderohet veprim i mjaftueshëm

për ushtrimin e përgjegjësive pastrimi i mbetjeve shtëpiake të cilat përdoren si burim ushqimi nga kafshët, qentë endacak. Në thelb situata nuk zgjidhet me pastrimin e mbetjeve shtëpiake por me trajtimin e qenve dhe maceve endacakë, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 10465/2011 si dhe nëpërmjet Urdhrave të nxjerra të ministrit të Bujqësisë. Vlerësojmë se fillimisht duhen ngritur së pari strukturat e duhura përkatëse brenda njësisive vendore sikurse është Bashkia Dropull dhe në vijim duke bërë edhe parashikimet e duhura ligjore në aktet rregullatore të kësaj Bashkie me anë të VKB-së përkatëse.

Mosparashikimi i strukturave përkatëse vendore dhe mosrregullimi i situatës ndikon drejtpërsëdrejti edhe në ruajtjen e banorëve të zonës nga përhapjet e sëmundjeve që mund të përcillen nga kafshimet e qenve dhe maceve endacake. Siguria e shëndeti publik sjell një detyrim nga ana juaj si bashki për të marrë masat e menjëhershme për të siguruar shëndetin dhe jetën e individëve në njësinë territoriale të Bashkisë Dropull.

Së pari, nën këtë fokus njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të sjellë në funksion të plotë strukturën përkatëse për shërbimin veterinar me qëllim që të bashkëpunojë me rrjetin e kontrollit të shërbimit veterinar që monitorohet nga Drejtoria e Politikave Veterinare në MBZHRAU dhe AKVMB-ja nëpërmjet të së cilave të mundësohet, ndër të tjera⁷:

- Mbrojtja nga përhapja e sëmundjeve të trasmetueshme të kafshëve me pronar ose jo;
- Inspektorët veterinar të mbajnë nën kontroll lëvizjen e kafshëve endacake. Në lidhje me situatën epizotike për çdo rast dyshimi njoftojnë drejtorinë rajonale të AKVMB;
- Veterinerët të bëjnë identifikimin e kafshëve të rrugës dhe administrojnë të dhënat në një regjistër të miratuar nga Struktura Përgjegjëse për Veterinarinë (*SPI*);
- Veterinerët të bëjnë hospitalizimin e qenve dhe të maceve të rrugës nëpërmjet organizimit, grumbullimit të tyre në vende të posaçme të miratuara nga autoritetet e vetëqeverisjes vendore. Të kryhet sterilizimi i tyre, me qëllim ndërprerjen e aktivitetit prodhues;
- Në mjediset e qendrave të hospitalizimit ose të qendrave të grumbullimit të kafshëve të miratuara nga autoritetet e vetëqeverisjes vendore të kryhet eliminimi i kafshëve me metodën e eutanazisë nga shërbimi veterinar, duke përdorur një nga produktet mjekësore veterinarë të miratuara nga legjislacioni në fuqi.

⁷ Në ligjin nr. 71/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në republikën e shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 54, parashikohet: *1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet:*

a) të bashkëpunojnë me autoritetin kompetent dhe strukturat e shërbimit veterinar për zbatimin e masave profilaktike, për kufizimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë;

b) të bashkëpunojnë me autoritetin kompetent dhe strukturat e shërbimit veterinar shtetëror për zbatimin e legjislacionit veterinar në funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla, thertoreve dhe kullotave;

c) të mbajnë nën kontroll dhe të zbatojnë kërkesat e këtij ligji për kontrollin e qenve e të maceve të rrugës, duke bashkëpunuar me shërbimin veterinar shtetëror;

ç) të përcaktojnë vendet e asgjësimit ose të grumbullimit të kadavrave të kafshëve dhe të bashkëpunojnë për eliminimin e tyre;

d) të marrin masa për rrethimin dhe ruajtjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve e të vendgroposjes të kadavrave dhe të ndalojnë hyrjen e kafshëve atje.

Parashikime të ngjashme janë dhënë edhe në VKM-në nr. 475/2021.

Pra, nga ana e Bashkisë Dropull duhet të bëhen parashikime të qarta ligjore në aktet nënligjore sikurse në Vendimin e Këshillit Bashkiak përkatës për të rregulluar problematikat e mësipërme. Të gjitha aktet ligjore kërkojnë dhe kanë si kusht ushtrimin e detyrave tuaja funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen e problemit të kontrollit, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, si dhe kontrollin e lëvizjes së qenve dhe maceve të rrugës.

Gjithashtu, vlerësojmë se edhe strukturat në nivel qendror duhet të angazhohen e të gjejnë mjetet e duhura për të bërë të zbatueshme politikat e tyre në nivel vendor. Pra, të hartojnë politika subvencionuese me qëllim alokimin dhe akordimin e fondeve të mjaftueshme për bashkitë e vogla, si në rastin konkret Bashkia Dropull, për të arritur përmbushjen e detyrimeve ligjore nga institucionet dhe organet përgjegjëse si në nivel vertikal ashtu dhe në atë horizontal.

Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe nxitjes së efektivitetit në ushtrimin e kompetencave të organeve administrative në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese dhe ligjit, e çmon me vend të bëjë këtë rekomandim për ndërhyrje dhe veprim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për përmbushjen e një të drejte dhe standardi për një ambient dhe mjedis sa më të shëndetshëm, të pastër dhe të sigurt.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj ushtrimin e përgjegjësisë ligjore me fokus të veçantë në zbatimin me rigorozitet të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim mbrojtjen e qytetarëve dhe individëve, si në rastin konkret të ankuesit i cili parashtron kërkesën për garantimin dhe përmbushjes së një të drejte.

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Mosveprimi evident nga ana juaj në këtë çështje nuk i respekton të drejtat e ligjshme të ankuesit, por përkundrazi është bërë shkak për shkeljen e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se:

“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit...,

- paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrative që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË

1. Marrjen e masave efektive në një kohë sa më të shpejtë nga Bashkia Dropull për pushimin e cenimit të të drejtave së qytetarëve nga rreziku që i shkaktohet nga prania e qenve dhe maceve endacakë.
2. Marrjen e masave për aktivizimin me funksion të plotë të shërbimit veterinar në njësinë vendore Bashkia Dropull.
3. Kryerjen e identifikimit të kafshëve të rrugës dhe administrimin e të dhënave në një regjistër të miratuar nga Struktura Përgjegjëse për Veterinarinë;
4. Hospitalizimin e qenve dhe të maceve të rrugës nëpërmjet organizimit, grumbullimit të tyre në vende të posaçme të miratuara nga autoritetet e vetëqeverisjes vendore.
5. Publikimin e plotë të akteve, elektronikisht, në faqen zyrtare të Bashkisë Dropull, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” me qëllim respektimin e transparencës nga autoritetet publike dhe të së drejtës për informim.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI